



Nr. 66

Viti i gjashtë i botimit

Nëntor 2018

Në këtë numër do të gjeni:

- 13 Tetori, Dita Botërore e Shpendëve Shtegëtar
- INCA takon anëtarët e Këshillit Bashkiak Librazhd
- Trainim në kuadër të Blue Land Project
- Aksione Komunitare për Zonat e Mbrojtura
- INCA mbyll me sukses projektin "Promovimi dhe advokimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura"
- Peshkatarët dhe komunitetet bregdetare drejt një menaxhimi të qëndrueshëm të mjedisit
- Çfarë mund të bëjmë për të shpëtuar breshkat e detit ???
- Trajnime për Organizatat e Shoqërisë Civile nga Rajoni / nga Qendra EDEN
- Prezantim i praktikave më të mira rreth Ekonomisë dhe Sipërmarrjes së Gjelbër / EDEN
- OSHC-të praktikojnë VNM-në të gjitha Fazat / Milieukontakt
- Si e përmirëson pjesëmarrja publike vendimmarrjen për çështjet mjedisore?
- ...me këtë rast Ju kujtojmë se... Njoftime

13 Tetori, Dita Botërore e Shpendëve Shtegëtar

13 Tetori - Dita Botërore e Shpendëve Shtegëtar
Unifikimi i zërave tanë për konservimin e shpendëve!

Dita Botërore e Shpendëve Shtegëtar ka filluar të festohet nga viti 2006 dhe ka si qëllim që të sjellë në vëmendjen e popullatës dhe të shërbejë si një ditë ndërgjegjësimi për mbrojtjen e shpendëve migrator dhe habitatet e tyre. Kjo ditë *Vijon në faqe 2*



Vijon nga faqe 1

organizohet nga Sekretariati i Konventës për Ruajtjen e Specieve Migruese të Kafshëve të Egra (Konventa e Bonit) dhe Marrëveshja për Ruajtjen e Shpendëve Ujor Shtegtar Afrikano-

Euroziatik, dy marrëveshje ndërkombëtare për mbrojtjen e jetës së egër që administrohen nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP). Më 26 Tetor 2017, në kuadër të CMS COP12 në Manila, Mjedisi për Amerikat (EFTA), Konventës për Ruajtjen e Specieve Migruese të Kafshëve të Egra dhe Marrëveshja për Ruajtjen e Shpendëve Ujor Shtegtar Afrikano-Euroziatik, u proklamua një partneritet inovativ për rritjen e ndërgjegjësimit të gjendjes së shpendëve migrues në mbarë botën. Partneriteti i ri zyrtar bashkon dy nga fushatat më të mëdha të edukimit të shpendëve në botë, Ditën Ndërkombëtare të Shpendëve Migratorë (IMBD) dhe Ditën Botërore të Shpendëve Migratorë (WMBD) në një përpjekje për të përforcuar njohjen dhe vlerësimin global të zogjve migrues, si dhe thekson nevojën urgjente për ruajtjen e tyre. Nga viti 2018 e tutje, fushata e re e përbashkët ka emrin e vetëm të "Ditës Botërore të Zogjve Migratorë", dhe ngjarjet kryesore për të përkujtuar këtë ditë do të organizohen dy herë në vit, të shtunën e dytë të majit dhe tetorit.

Viti 2018 ka shënuar një fillim të ri për Ditën Botërore të Zogjve Migratorë, pasi ai tani bashkon korridoret kryesore të fluturimit të zogjve të planetit, ose fluturimet, përkatësisht fluturimet afrikano-eurasiatike, aziatiko-australiane dhe amerikane. Përveç kësaj, për të bërë festimet edhe më të suksesshme dhe më të rëndësishme për përkrahësit e zogjve anembanë botës, WMBD tani do të ketë dy ditë përkujtimi gjatë vitit - të shtunën e dytë të majit dhe tetorit - dhe mund të vazhdohet të përkujtohet apo festohet gjatë gjithë vitit, sa herë që zogjtë migrues janë të pranishëm në një lokalitet të caktuar.



Prandaj, viti 2018 është një vit i rëndësishëm tranzicioni në historinë e Ditës Botërore të Zogjve Migratorë. Duke sjellë së bashku edhe më shumë njerëz në mbarë botën, WMBD synon të arrijë në një audiencë më të gjerë dhe të plotësojë mesazhin e saj për ruajtjen e shpendëve. Si një platformë e re globale që unifikon përpjekjet në mbarë botën, WMBD do të përforcojë edukimin dhe ngritjen e vetëdijes për nevojën për të mbrojtur zogjtë migrues dhe habitatet e tyre - në të gjitha nivelet dhe në të gjitha anët e botës.

WMBD i kushton vitit 2018 fluturimet e saj kryesore dhe bashkëpunimit të ri ndër-fluturues

Me "Unifikimin e zërave tanë për konservimin e shpendëve", si temë e saj për vitin 2018, në "Vitin e zogjve", WMBD po fokusohet në mënyrë të qartë dhe të fuqishme në zhvillimin e identitetit të vet të ri dhe nevojës për përkujtim nga njerëzit që festojnë në mbarë botën për të komunikuar dhe mësuar nga njëri-tjetri, përtej kufijve, brenda dhe mes korridoreve të fluturimit në botë. Nëpërmjet aktiviteteve që po ndërmerren në këto tre korridore fluturimi, si dhe shkëmbimit të informacionit, WMBD dëshiron të rrisë nivelin e ndërgjegjësimit për kërcënimet - si të përgjithshme dhe specifike - me të cilat ballafaqohen zogjtë. Duke krahasuar përvojat dhe shqetësimet e tyre, duke ndarë ngjarjet dhe tregimet e tyre, njerëzit në mbarë botën do të bëjnë zërat dhe veprimet e tyre të shtrihen edhe më tej, gjatë gjithë rrugëtimit, duke nënvizuar faktin se konservimi i zogjve është me të vërtetë një çështje globale.

INCA takon anëtarët e Këshillit Bashkiak Librazhd

Librazhd - 4 Tetor 2018 - Në kuadër të zbatimit të projektit "Promovimi dhe advokimi për një menaxhim të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura" (Faza II), Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA), zhvilloi një takim me anëtarët e Këshillit Bashkiak Librazhd. Qëllimi i takimit ishte prezantimi, njohja dhe diskutimi mbi vlerat dhe problematikat që shqetësojnë Parkun Kombëtar Shebenik-Jabllanicë.

Në takim morën pjesë anëtarë të Këshillit Bashkiak Librazhd, përfaqësues të AdRZM Elbasan, të Forumit Lokal Mjedisor, OJF të zonës etj.

Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të Programit SENIOR-II, i zbatuar nga REC-Albania, me financim të Qeverisë Suedeze (Ambasada Suedeze në Tiranë)



Trainim në kuadër të Blue Land Project

Podgoricë - 16 Tetor - 2018 - Partnerët dhe ekspertët të Projektit Blue Land u takuan në Podgoricë (Mali i Zi) gjatë 15-17 tetorit për të ndarë punën e bërë derimë tani mbi identifikimin e shërbimeve të ekosistemit në tri zonat e projektit (Ada Bojana - Mali i Zi, Porto Palermo - Shqipëri dhe Tricase - Itali) si dhe për të përcaktuar hapat e mëtejshëm për mbrojtjen e habitateve dhe shërbimeve të ekosistemit.

Projekti BLUE LAND është financuar nga Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi dhe zbatohet nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura - AKZM, Instituti i Ruajtjes së Natyrës në Shqipëri - INCA, Ministria e




Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Malit të Zi, Universiteti i Malit të Zi - Instituti i Biologjisë Detare, Instituti Kërkimor i Bashkëpunimit - ICR dhe Ciheam - Bari - Itali.

Aksione Komunitare për Zonat e Mbrojtura

Përmet - 26-27 Tetor 2018 - Në kuadër të projektit "Aksione Komunitare për Zonat e Mbrojtura-A.C.A.P.", filloi fushata ndërgjegjëse dhe edukuese e titulluar "Thirrje shkollave për veprim", me mësueset dhe nxënësit e shkollave dhe komunitetin pranë zonave të mbrojtura, ku për qarkun Gjirokastrë është përzgjedhur Parku Kombëtar "Bredhi i Hotovës-Dangëlli".

Qëllimi i kësaj fushate është të përmirësojë dhe të



Në këtë kuadër u zhvillua trajnimi me mësueset e shkollave 9-vjeçare (mësues të ciklit fillor si dhe mësues të lëndës gjeografi dhe biologji në klasat e nivelit 5-9) pranë zonave pilote që merren në konsideratë nga ky projekt. Trajnimit u zhvillua nga ekspertë të IZHA, eksperte të AKZM, INCA dhe COSV bazuar në modelet e edukimit mbi riciklimin si

rrisë ndërgjegjësimin dhe edukimin mjedisor mbi mbrojtjen e zonave të ndjeshme natyrore dhe të inkurajojë perceptimin dhe sjelljen ndaj natyrës si dhe të nxisë frymëzimin për aksione me fokus ruajtjen dhe promovimin e natyrës.

Fushata ndërgjegjëse "Thirrje shkollave për veprim" zbatohet nga stafi i AdRZM Gjirokastrë, Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA), në bashkëpunim me organizatën italiane COSV.



dhe interpretimin e vlerave të ZM dhe mundësitë për ti shfrytëzuar ato si një laborator i hapur në natyrë në shërbim të kurikulave aktuale mësimore.

Ky projekti mbështetet nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim.

INCA mbyll me sukses projektin "Promovimi dhe advokimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura"

Tiranë - 29 Tetor 2018 - Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) dhe Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri, në kuadër të programit SENIOR-II, "Mbështetje për OSHC-të Mjedisore në Shqipëri", zbatuar nga REC Shqipëri, me financim të Qeverisë Suedeze, zhvilluan Konferencën Kombëtare (përmblylëse) "Prezantimi i vlerësimeve dhe rekomandimeve të monitorimit të pjesëmarrjes publike dhe përfshirjes së organizatave të RrMN në vendimmarrje për një menaxhim të qëndrueshëm e shumë përdorimshëm të Zonave të Mbrojtura Mjedisore", në kuadër të projektit "Promovimi dhe advokimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura". INCA në këtë konferencë përmblylëse ndau dhe diskutoi me pjesëmarrësit vlerësimet dhe rekomandimet mbi përfshirjen e organizatave të RrMN në vendimmarrje për një menaxhim të qëndrueshëm të Zonave të Mbrojtura Mjedisore në Shqipëri.



Konferenca Kombëtare u mbajt me pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë nga 16 zona të mbrojtura në rajonet pilote të përzgjedhura: Tiranë (Tiranë, Dibër), Vlorë (Vlorë), Gjirokastrë (Përmet, Dropull), Korçë (Korçë, Pustec), Mat (Ulëz), Durrës (Krujë), Kukës (Kukës, Tropojë), Shkodër (Shkodër, Malësi e Madhe), Elbasan (Librazhd) dhe Fier (Divjakë). Gjithashtu të pranishëm në aktivitet ishin përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, AdRZM në rrethe, përfaqësues nga pushteti vendor, përfaqësues nga Organizata të Shoqërisë Civile etj.

Gjatë konferencës u prezantua puna 7-mujore për advokimin dhe nxitjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje si një shtyllë e rëndësishme që qëndron në themel të mirëfunksionimit të një sistemi

demokratik. Çdo organizatë e Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës në Shqipëri paraqiti në mënyrë të përmbledhur sfidat dhe arritjet e projektit dhe në fund të tij u prezantuan kronikat/emisionet e dedikuara televizive të realizuara në kuadër të këtij projekti.

Qëllimi kryesor i projektit ishte të forcojë rolin pjesëmarrës dhe advokues të shoqërisë civile në promovimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe veçanërisht Zonave të Mbrojtura. Risia e këtij projekti konsistoi në krijimin e

grupimeve lokale për të marrë pjesë në proceset advokuese dhe këshilluese pranë strukturave vendore përgjegjëse për menaxhimin e burimeve natyrore.

Nëpërmjet këtij projekti u synua një përjasje strategjike e angazhimit të shoqërisë civile në adresimin afatgjatë të


problematikës dhe promovimit të vlerave kryesore në 16 Zona të Mbrojtura Mjedisore (ZMM) të përzgjedhura në rajonet: Tiranë, Vlorë, Gjirokastrë, Korçë, Mat, Kukës, Shkodër, Elbasan dhe Fier.

Vëmendja në këtë aktivitet ju kushtua jo vetëm funksionimit të mekanizmave të ngritur në nivel strukturash vendimmarrës për përfshirjen e publikut por edhe rolit të shoqërisë civile në tërësi, të medias, si dhe evidentimin e mundësive për forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi.

Ky aktivitet është realizuar nga Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) në kuadër të projektit "Promovimi dhe advokimi për një menaxhim të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura", si pjesë e Programit "Mbështetje për organizatat mjedisore të shoqërisë civile në Shqipëri SENIOR-II, i cili zbatohet nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC Shqipëri) dhe financohet nga Qeveria Suedeze.

Peshkatarët dhe komunitetet bregdetare drejt një menaxhimi të qëndrueshëm të mjedisit

Vlorë - 10 Tetor 2018 - Në kuadër të NEMO MED Project, iniciativa për mbështetjen e komuniteteve lokale marine për përmirësimin dhe përfshirjen e grupeve të interesit në zhvillimin e qëndrueshëm të peshkimit, u realizua webinar i me temë "Peshkatarët dhe komunitetet bregdetare drejt një menaxhimi të qëndrueshëm të mjedisit".



Gjatë këtij webinar i morrën pjesë përfaqësues nga vende të ndryshme të mesdheut duke përfshirë këtu Tunizinë, Libinë, Italinë etj. Ky webinar luajti një rol mjaft të rëndësishëm në ndarjen e eksperiencave midis peshkatarëve të vendeve të ndryshme dhe rolin që ata kryejnë në menaxhimin e mjedisit bregdetar. Duke u njohur me mënyrat e menaxhimit që vendet fqinje realizojnë në kuadër të një funksionimi sa më të mirë të zonave të mbrojtura detare, me qëllim rritjen dhe aftësimin në mbrojtjen dhe ndërgjegjësimin lidhur me këto zona, mund të rritet ndërgjegjësimi për një menaxhim më të mirë edhe në vendin tonë, duke i përdorur ato si shembuj të mirë.

Disa prej pikave kryesore të trajtuara gjatë këtij webinar i ishin:

Çfarë nënkuptojmë me peshkim të qëndrueshëm? Do të thotë të lemë mjaftueshëm burime në detet tona, duke respektuar në këtë mënyrë habitatin dhe duke siguruar ata persona, jeta e të cilëve varet nga peshkimi.

Burime të qëndrueshme të peshkut - Peshkimi duhet të jetë në atë nivel, që nuk arrin të sjell impakte negative

në popullatat e peshqve, të cilat duhet të jenë produktive dhe të shëndetshme

Minimizimi i impakteve negative - Të qenit të kujdesshëm edhe me ato lloje të cilat nuk janë objekt peshkimi, që për arsye të ndryshme bien në rrjetat e peshkatarëve nëpërmjet një fenomeni që ne e quajmë "bycatch"

Menaxhim efektiv i peshkimit - Funksionimi i kooperativave të peshkimit dhe ligjit të peshkimit. Qëndrueshmëria e mjedisit është shndërruar në një çështje globale për ruajtjen e burimeve natyrore. Komunitetet të cilat janë të lidhura në mënyrë të drejtëpërdrejtë me burimet mjedisore kanë një ndikim mjaft tregues në përdorimin e këtyre burimeve. Duke u bazuar në këto ndikime, ata shpesh përballen me kushte të këqija të mbijetesës, të cilat vijnë si rezultat i impakteve të mëdha në këto mjedise ku ata jetojnë dhe punojnë. Në mënyrë që të kemi një menaxhim më të mirë të mjedisit, pika më kryesore që duhet mbështetur dhe duhet ndërgjegjësuar janë pikërisht këto komunitete.

Një bashkëpunim midis qeverisë e cila funksionon nëpërmjet ligjeve të cilët duhen zbatuar, studiuesve të cilët shpjegojnë të gjithë impaktet nga ana biologjike dhe fizike, komunitetit lokal si dhe peshkatarëve do të sillte një menaxhim të të mirë të zonave bregdetare, veçanërisht kur bëhet fjalë për zona me potencial të lartë të biodiversitetit, ekonomik dhe turistik siç është në vendin tonë edhe Porto Palermo.



Çfarë mund të bëjmë për të shpëtuar breshkat e detit ???

Vitet e fundit, në detet e Shqipërisë është vënë re një numër më i madh i breshkave të detit. Këto të dhëna janë mbledhur nga peshkatarët dhe rastet e gjetjes së breshkave të plagosura ose për fat të keq të ngordhura. Për këtë ka lindur nevoja e krijimit të qendrave të rehabilitimit dhe shpëtimit të breshkave të detit. Në Shqipëri ndodhen dy qendra rehabilitimi për këto specie: një e vendosur në zonën e Patokut, e mbështetur nga Prof.Dr. Idriz Haxhiu dhe tjetra në zonën e Radhimës, nën drejtimin e AdRZM-së së Vlorës dhe UNDP-së. Shtimi i rasteve të breshkave të dëmtuara ka rritur punën dhe mbështetjen që këto dy qendra kanë dhënë në shpëtimin dhe ruajtjen e breshkave të detit.

Cilat janë arsyet e dëmtimit të breshkave të detit?

Ne të gjithë i duam ushqimet e detit. Në disa raste sigurimi i ushqimit të detit, nëpërmjet mënyrave të ndryshme të peshkimit mund të bëhet shkas për dëmtimet e specieve të tjera si breshkat e detit, delfinët etj. Kjo ndodh pasi pajisjet e peshkimit aksidentalisht kapin edhe specie të tjera të cilat nuk janë target. Kjo mënyrë kapje quhet ndryshe "bycatch". Në disa raste peshkatarët mund ti lëshojnë, por në raste të tjera ata i gjuajnë për të ngordhur ose mund t'i përdorin si ushqim.

Po ashtu, deti Mesdhe njihet si një ndër detet më të ndotur në botë. Një numër i madh i plastikave dhe mbeturinave të tjera ndodhet në fundet e detit Mesdhe dhe shumë të tjera pluskojnë mbi ujë. Plastika thith lëndë kimike në vetvete, gjë e cila shkakton helmimin e ujit jo vetëm për speciet detare por edhe për ne. Por shpesh herë lloje si *Caretta caretta*



qese plastike, por një breshkë nuk mundet, prandaj

arsyet e ngordhjes së një numri shumë të madh të breshkave të detit është edhe prania e qeseve plastike në stomakun e tyre, gjë e cila nuk lejon breshkën të ushqehet dhe të marr frymë lehtësisht.

Kohët e fundit në Shqipëri po zhvillohet shumë turizmi detar. Kjo ka çuar në rritjen e numrit të varkave dhe objekteve të tjera lëvizëse në det. Breshkat e detit janë zvarranikë të cilët çdo 20 minuta për të marrë ajër, i afrohen sipërfaqes. Por në disa raste prania e këtyre mjeteve ujore mund të shkaktojë dëmtimin e karapaksit të tyre, dëmtim prej të cilit një pjesë e breshkave të detit nuk j'a dalin dhe ngordhin.



Raste të shumta janë afruar afër qendrave të rehabilitimit të breshkave të detit. Në qendrën e Radhimës po bëhet një punë e madhe për rehabilitimin e tyre, falë punës së punonjësve të AdRZM-së, ku dhe ne si shoqatë që kemi si qëllim ruajtjen e mjedisit dhe për pasojë edhe çdo gjë e lidhur me mjedisin japim mbështetjen tonë.

Gjatë rastit më të fundit këtë Shatator, një breshkë deti e dëmtuar u gjet në plazhin e Divjakës, e ngecur në vegjetacionin pranë vijës bregdetare. AdRZM-ja e Fierit njoftoi menjëherë pas gjetjes qendrën e rehabilitimit të Radhimës. Pas transportimit të sigurt të breshkës së detit, u morrën masat e nevojshme për të siguruar ndihmën e saj. Sipas vëzhgimeve breshka e detit e cila morri emrin "Teuta" prej kohësh kishte një problem lidhur me një rën nga gjymtyrët e përparme, e cila ishte e prerë. Ky ishte një problem i hershëm dhe mendohet të ketë ardhur si pasojë e

Vijon në faqe 8

Vijon nga faqe 7 prerjes së saj nga një helikë e



mjeteve ujore. Po ashtu, karapaksi i saj ishte i dëmtuar së fundmi ku viheshin re gërvishtje në gjatësinë e tij dhe thyrje të vogla, gjë që tregon përplasjen e breshkës me

mjet tjetër ujor. Kjo ka bërë që breshka të ndihet e lodhur dhe të dalë në breg duke j'u afruar edhe vegjetacionit ku dhe kish ngecur. Qëndrimi i saj prej pak kohësh aty, ka ndikuar në zënien e parazitëve në plagët e saj të hapura. Pas këtyrë vëzhgimeve të detajuara, karapaksi i breshkës u trajtua me solucione kundër parazitëve dhe u mbajt në akuariumin e qendrës me ujë deti. Pas një ditë u vu re largimi i parazitëve dhe breshka filloi të ushqehet. Më pas duke vënë re aftësinë e saj për të lëvizur dhe për t'u ushqyer lehtësisht u vendos të bëhej lëshimi i saj në habitatin e saj natyror.

Ndërgjegjësimi i peshkatarëve

Peshkatarët janë pika kyçe për t'u njohur me pjesën më të madhe që ndodhet në detet tona, qoftë për specie e ndryshme ashtu edhe për çdo problem që një mjedis ujor mund të ketë. Por ndonjëherë raste të tilla si rënia e specieve të tjera në rrjetat e tyre, i gjen ata të papërgatitur dhe të pa informuar me mënyrën si duhet të veprojnë. Disa prej tyre i shohin breshkat e detit si kërcënim, prandaj i vrasin ato. Disa përfitojnë dhe i përdorin si ushqim, ose për të marrë karapaksin e tyre. Disa janë detarë të vërtetë duke i lëshuar menjëherë pas rënies në rrjeta. Kohët e fundit

ndërgjegjësimi për mjedisin dhe pjesët e tij është rritur, falë punës së ekspertëve dhe institucioneve mjedisore për të informuar njerëzit për çdo element që mund të lidhet me aktivitetet specifike të tyre. Në qendrën e Radhimës, ndodhet edhe "Shoqata për Peshkatarët e Përgjegjshëm", e drejtuar nga Baci Dermishaj, të cilët kanë bërë një punë shumë të mirë, në radhë të parë me ndërgjegjësimin e tyre dhe më pas me ndërgjegjësimin e peshkatarëve të tjerë. Kjo shoqatë i ka dhënë një ndihmë të madhe administratës në shpëtimin e një numri të madh të breshkave të detit.

Opinionin publik në përgjithësi ka indiferencë të theksuar ndaj çështjes së diversitetit natyror të bimëve dhe të kafshëve, aq më shumë ndaj specieve dhe popullatave në rrezik zhdukje siç është konkretisht çështja e breshkave të ujit. Kanë disa njohuri sipërfaqësore vetëm punonjësit e peshkimit, të cilët në mënyrë rastërore japin ndihmesën e tyre për mbijetesën e breshkave të detit. Në këto kushte ne si INCA na del për detyrë të ndërgjegjësojmë me të gjitha format opinionin e gjerë, kryesisht ndaj atyre që jetojnë pranë brigjeve apo pushojnë gjatë verës, të japin ndihmesën e mundshme me veprime konkrete ose me informacion



të dobishëm në lidhje me çka ata bien ndesh.



Trajnime për Organizatat e Shoqërisë Civile nga Rajoni / nga Qendra EDEN

Një trajnim dy-ditor për organizatat e shoqërisë civile nga Shqipëria dhe Maqedonia mbi Ekonominë e Gjelbër u zhvillua në Tiranë, më 15-16 Tetor 2018. Trajnimi mbledhi rreth 30 OSHC të cilat patën mundësinë të përmirësonin njohuritë dhe aftësitë e tyre në tema që lidhen me ekonominë e gjelbër: si sipërmarrja e gjelbër, parimet e ekonomisë së gjelbër, zhvillimi dhe praktikat mbi ekonominë e gjelbër në Bashkimin Evropian, lëvizjet e reja në këtë fushë, etj.

Trajnimi ishte pjesë e projektit "GEAR - Ekonomia e Gjelbër për një Zhvillim Rajonal", që ka si qëllim rritjen e aktiviteteve dhe ndikimit të organizatave të shoqërisë civile nga Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia, në mbrojtje të mjedisit përmes rrjeteve, duke forcuar kapacitetet e tyre dhe duke promovuar ekonominë e gjelbër. Projekti realizohet në partneritet me organizatën FORS Mal i Zi i cili është dhe koordinatori i projektit, Qendra EDEN nga Shqipëria, SMART Kolektiv nga Serbia, Qendra për përkrahje dhe zhvillim nga BiH, EKO Svest nga Maqedonia dhe Shoqata Slap nga Kroacia.

Përveç këtij trajnimi, në periudhën e ardhshme do të organizohen trajnime në temat e mëposhtme në bashkëpunim me partnerët në projekt: Advokim dhe Lobim, Menaxhim i Ciklit të Projektit, Pjesëmarrje e Publikut në Vendimarrje, Studim dhe kërkim mbi zhvillimin e Ekonomisë së Gjelbër, si dhe Monitorim të Politikave Publike si dhe Përmirësim i Bashkëpunimit me pushtetin qendror.

Përveç trajnimeve, projekti përfshin një sërë aktiviteteve që synojnë përmirësimin e mëtejshëm të kapaciteteve dhe ndikimeve të OSHC-ve në mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e ekonomisë së gjelbër, si: familjarizimi me modelet e praktikave të mira në ekonominë e gjelbër dhe sipërmarrjen e gjelbër

përmes vizitave studimore në BE dhe prezantimet e organizuara në vendet e synuara, subgrantime për organizatat e shoqërisë civile, konferencat rajonale për ekonominë e gjelbër dhe sipërmarrjen e gjelbër, zhvillimin e një Studimi mbi mundësitë për zhvillimin e ekonomisë së gjelbër në rajonin e synuar.

Një rezultat shumë i rëndësishëm i pritur i projektit është krijimi i rrjeteve të organizatave të shoqërisë civile nga rajoni që merren me tema të lidhura me mbrojtjen e mjedisit, të cilat do të çojnë në përmirësimin e bashkëpunimit, shkëmbimit të njohurive, përvojës dhe mësimave të nxjerra në këtë fushë; bazë për bashkëpunimin e tyre të ardhshëm dhe zhvillimin e projekteve dhe iniciativave të përbashkëta.



Për më shumë informacion mbi projektin mund të kontaktoni

Albana Joxhe, Qendra EDEN,
tel: 067 20 60 447 dhe

email: albana.bregaj@eden-al.org.

Prezantim i praktikave më të mira rreth Ekonomisë dhe Sipërmarrjes së Gjelbër / EDEN

Qendra EDEN në mars të këtij viti filloi me zbatimin e një projekti të ri "Ekonomia e Gjelbër për një Zhvillim Rajonal" me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe ndikimit të organizatave të shoqërisë civile nga Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia, në mbrojtje të mjedisit përmes rrjeteve, duke forcuar kapacitetet e tyre dhe duke promovuar ekonominë e gjelbër.

Një projekt ky (3) tre-vjeçar do të zbatohet në vendet e sipërpërmendura dhe aktivitetet kryesore përfshijnë trajnimet për përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile për ekonominë e gjelbër, advokimin publik dhe lobimin, pjesëmarrjen në vendimmarrje, monitorimin e politikave publike, menaxhimin e ciklit të projektit, etj... familjarizimi me modelet e praktikave të mira në ekonominë e gjelbër dhe sipërmarrjen e gjelbër përmes vizitave studimore në BE dhe prezantimet e organizuara në vendet e synuara, subgrantime për organizatat e shoqërisë civile, konferencat rajonale për ekonominë e gjelbër dhe sipërmarrjen e gjelbër, zhvillimin e një Studimi mbi mundësitë për zhvillimin e ekonomisë së gjelbër në rajonin e synuar, etj.

Një rezultat shumë i rëndësishëm i pritur i projektit është dhe prezantimi i datës 17 tetor mbi praktikën më të mira rreth Ekonomisë dhe Sipërmarrjes së Gjelbër, nga vendet e EU. Ky prezantim u mbajt në

ambjentet e Agjencisë Rajonale për Zhvillim Shkodër nga 2 ekspertë kroatë të cilët janë dhe partner të këtij projekti dhe ekspertë në fushën e Ekonomisë së Gjelbër! Në këtë prezantim ishin të pranishëm OSHC lokale, përfaqësues të Prefekturës Shkodër, të rinj, media etj, të cilat treguan mjaft interes për të mësuar rreth eksperiencave dhe praktikave më të mira në vendet e EU. Në fund të prezantimit u zhvillua dhe njoftimi për shtyp i parë për këtë projekt, me një pjesëmarrje të gjerë të mediave të rrethit Shkodër por dhe ato kombëtare.

Projekti realizohet në partneritet me organizatën FORS Mal i Zi i cili është dhe lideri i projektit, Qendra EDEN nga Shqipëria, SMART Kolektiv nga Serbia, Qendra për përkrahje dhe zhvillim nga BiH, EKO Svest nga Maqedonia dhe Shoqata Slap nga Kroacia.

Projekti financohet nga Bashkimi Evropian në kuadër të Mbështetjes së Shoqërisë Civile dhe Medias 2016-2017!

Për më shumë informacion mbi projektin mund të kontaktoni

Albana Joxhe, Qendra EDEN,
tel: 067 20 60 447

dhe email: albana.bregaj@eden-al.org.



OSHC-të praktikojnë VNM-në të gjitha Fazat / Milieukontakt

Pas një pune dy vjeçare për zbatimin e projektit "OSHC-të OSHC-të praktikojnë VNM-në të gjitha Fazat" në kuadër të CO-SEED - "Shoqëria Civile vepron për Zhvillimin Social-Ekonomik mbi Bazat e një Mjedisit të Shëndetshëm", organizata Milieukontakt realizoi konferencën finale me gjetjet dhe rezultatet e arritura ndër dy vite projekt.

Praktika e re RIA (vlerësimi i ndikimit të kuadrit rregullator) ku specifikisht ka të bëjë me vlerësimin Ex-Post të ndikimit të ligjit "Për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" është një domosdoshmëri e procesit të përmirësimit të politikave publike dhe legjislacionit në

kuadër të integritetit në Bashkimin Evropian dhe përbën një ndryshim të rëndësishëm në punën e Qeverisë Shqiptare. Zbatimi i RIA-s është një kërkesë gjithashtu edhe nga Bashkimi Evropian, ku përndryshimet e aplikuara, të komunikohet në mënyrë të hapur

dhe transparente, për të krijuar dhe marrë mbështetje të gjerë për reformat nga organizatat e shoqërisë civile e shtetasit shqiptar në tërësi.

Në konferencë u prezantuan gjetjet e projektit nga Milieukontakt, projekt, i cili ka pasur një shtrirje të gjerë territoriale, kohore dhe lëndore. OSHC-të e përfshira në projekt, por jo vetëm, kanë qënë pjesë aktive në dëgjuesat publike të sipërmarrjeve dhe projekteve të ndryshme, të cilat direkt apo indirekt ndikojnë negativisht në mjediset ku edhe zbatohen.

Element i rëndësishëm i konferencës ishte edhe botimi i ri mbi listat e kontrollit përshqyrtimin e studimeve të vlerësimit të ndikimit në mjedisor. Ky material bën të mundur për komunitetin e gjerë të vlerësojë dhe kontrollojë raportet e Vlerësimit të Ndikimit në

Mjedis. Botimi për listat për vlerësimin e kontrollit është një botim praktik dhe mjaft i vlefshëm për aktorët e interesuar në kontrollin e VNM-ve.

Rastet e dëgjuesave të monitoruara nga OSHC-të për VNM-te e projekte të ndryshme ka qënë rreth 300. Përgjatë monitorimit të të gjithë procesit, duke filluar që prej njoftimeve, datave dhe vendeve për realizimin e dëgjuesave publike ka pasur shumë mangësi, të cilat nëse përmirësohen sipas rekomandimeve të nxjerra në konferencë do përmirësojnë procesin, si dhe do të përmbushin detyrimin ligjor të informimit të publikut apo realizimin cilësor të tyre.



Në konferencë gjetjet dhe rezultatet e përftuara përgjatë zbatimit të projektit u ndanë mes organizatave të shoqërisë civile, përfaqësuese nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Zbatimi i një

projekti të tillë, ka përmirësuar kapacitetet e shoqërisë civile për vlerësimin dhe monitorimin e VNM-ve, vendosi ura komunikimi dhe bashkëpunimi mes institucioneve shtetërore të fushës, duke ofruar edhe rekomandimet për përmirësimin e punës së tyre. Puna e kryer përgjatë zbatimit të projektit nxiti OSHC-të për vazhdimin e procesit edhe më tej, duke qënë mbështetës dhe lehtësues për komunitetin e interesuar.

Ky aktivitet është mbështetur financiarisht nga Projekti "Shoqëria Civile Vepron për Zhvillimin Social-Ekonomik mbi Bazat e një Mjedisit të Shëndetshëm" (CO-SEED) me fonde të Bashkimit Evropian dhe që zbatohet nga Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA).

Si e përmirëson pjesëmarrja publike vendimmarrjen për çështjet mjedisore?

**CO-SEED***Fragmente nga manuali i praktikave më të mira botërore***Shteti: Shqipëri****Rasti: Zhvillimi i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë së Tiranës***Theksi: Vendimmarrja transparente dhe gjithëpërfshirëse sjell zgjidhje që pranohen dhe mbështeten nga një grup i gjerë palësh interesi.*

Sipas ligjit, Plani i Përgjithshëm Vendor i përgatitur për Bashkinë e Tiranës duhej t'i nënshtrohej një VSM-je. Informacionet lidhur me këtë proces ishin të disponueshme në internet (në faqen e Bashkisë, dhe faqen e zhvilluesve të VSM-së), në kanale televizive, dhe gazeta. VSM-ja gjithashtu iu përcoll OJQ-ve mjedisore me anë të emailit.

Data fillestare e dëgjësës publike u shty në një datë

të mëvonshme për t'iu lënë kohë të mjaftueshme palëve të interesuara të lexonin dokumentet përkatëse (megjithatë ato u shpërndanë një ditë para datës së dëgjësës). Dëgjesa publike u ndoq nga palë të shumta interesi, ku përfshiheshin: OJQ mjedisore, ekspertë të pavarur të mjedisit, qytetarë të Tiranës, studentë, gazetarë, pjesëtarë të sektorit të biznesit, si dhe përfaqësues zyrtarë të bashkisë dhe ministrive përkatëse. Përpos komenteve gjatë dëgjësave publike, palët e interesit i ndanë mendimet e tyre me shkrim me konsulentin përgjegjës për përgatitjen e VSM-së. Ky proces i pjesëmarrjes publike solli ndryshimin e planit të zhvillimit duke siguruar marrjen parasysh të zonave dhe korridoreve të gjelbra, transportit publik, zonave të reja të kontrollit të zhvillimit, dhe përmirësimeve të trashëgimisë arkitekturore të qytetit.

...me këtë rast Ju kujtojmë se 52 vjet më parë...

...me VKM nr. 96, **datë 21.11.1966** shpallen Parqe Kombëtare, kryesisht ekosistemet pyjore, si më poshtë:

1. Thethi, me sip. 2630ha; 2. Lura, me sip. 1280ha; 3. Llogara, me sip. 1010ha; 4. Bredhi i Drenovës, me sip. 1380ha; 5. Dajti, me sip. 3300ha dhe 6. Pisha e Divjakës, me sip. 1250ha.

Aktualisht, bazuar në dispozitat e ligjit "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, disa prej tyre kanë ndryshuar sipërfaqen, duke ruajtur statrusin e Parkut Kombëtar.

Parku Kombëtar "Thethi", sipas studimit të ri që po kryhet, do të përfshihet në sipërfaqen e Parkut Kombëtar Ndërkufitar "Alpet e Shqipërisë", me sipërfaqe të përgjithshme 86 mijë ha.

Parku Kombëtar "Dajti", me VKM nr. 402, datë 21.06.2006, u rishpall "Park Kombëtar" me sipërfaqe të zgjeruar 29,384.18ha, i shtrirë në Qarkun e Tiranës dhe të Durrësit.

Parku Kombëtar "Pisha e Divjakës", me VKM nr. 687, datë 19.10.2007, u rishpall Park Kombëtar "Divjakë-Karavasta", me sipërfaqe të zgjeruar 22.230.2 ha, në të cilin përfshihet edhe pjesa e territorit në

administrim të Kavajës (Gosë) dhe Fierit (Libofshë). Gjithashtu, pjesë e Parku Kombëtar, u bë dhe laguna e Karavastasë, me sip. 5000 ha, e cila sipas VKM nr. 102, datë 15.1.1996 kishte statusin "Rezervat Strikt Natyror". Njëherazi, ky territori, si ekosistem natyror veçanërisht i mbrojtur, ka statusin e Zonës Ramsar, me VKM nr. 413, datë 22.8.1994...

...13 vjet më parë ...

...me VKM nr. 684, **datë 02.11.2005**, shpallet zona shqiptare e Liqenit të Shkodrës "Rezervat Natyror i Menaxhuar", ndërsa me VKM nr.682, **datë 02.11.2005**, shpallet "Peizazh ujor/tokësor i mbrojtur" zona e lumit Buna, së bashku me delten dhe ishullin e Franc Jozefit, rezervatin e Velipojës, lagunën e Vilunit, plazhin e Baks-Rrjollit, kënetën e Domnit, si dhe territoret përreth tyre.

Për Rezervatin Natyror të Menaxhuar "Liqeni i Shkodrës" është hartuar dhe plani i menaxhimit (Qershor të vitit 2012), i miratuar me urdhër të Ministrit të Mjedisit nr. 815, datë 21.11.2012.

Me VKM nr.683, **datë 02.11.2005**, sipërfaqja prej
Vijon në faqe 13

Vijon nga faqe 12 49,562.0ha, e cila përfshin Liqenin e Shkodrës sëbashku me Lumin e Bunës dhe zonat ligatinore përreth tyre, të shpalljen zonë natyrore veçanërisht të mbrojtur dhe përfshirjen në listen e Konventës "Ramsar", "Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujore"...

...6 vjet më parë ...

...miratohet ligji nr. 111/2012, **datë 15.11.2012** "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore". Ligj synon: a) mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, të ujërave të brendshme detare, të ujërave territoriale, zonave ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore, si dhe të statusit të tyre; b) sigurimin, ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore, të domosdoshme për jetën dhe për zhvillimin social e ekonomik të vendit; c) shpërndarjen e drejtë të burimeve ujore, sipas qëllimeve të përdorimit dhe drejtimin e administrimit e efektshëm të tyre; ç) mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja, shpërdorimi dhe harxhimi mbi nevojat faktike; dhe d) përcaktimin e kuadrit institucional, në nivel kombëtar e vendor, për vënien në jetë të një politike kombëtare për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore në të mirë të komunitetit dhe interesave sociale dhe ekonomike të vendit.

Konventat Ndërkombëtare ku Shqipëria është palë

Konventa e Diversitetit Biologjik (KDB)

U nënshkrua më **5 Janar 1994**. Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë më **10.11.1996**. Miratimi i kësaj konvente u jep të drejtën palëve të përdorin dhe të menaxhojnë informacionin e fushës së biodiversitetit. Ajo u rekomandon anëtarëve të OJF-ve dhe të insitucioneve shtetërore: a) përdorimin e informacionit; b) plotësimin dhe standartizimin e të dhënave; c) ngritjen e një data-base për biodiversitetin dhe d) ndërmarrjen e projekteve konkrete, me synim ruajtjen e llojeve të rrezikuara dhe në rrezik zhdukjeje. Ruajtja e natyrës dhe e biodiversitetit, në vendin tonë, ka nisur prej vitesh,

...8 vjet më parë ...

...me VKM nr.995, **datë 03.11.2010**, ekositemi natyror ligatinor i deltës së Lumit Mat, laguna e Patokut, Godulla dhe delta e Lumit Ishëm, me sip. 5000.7ha, shpallet "Rezervat Natyror i Menaxhuar".

VKM nr.693, **datë 10.11.2005**, rishpall "Park Kombëtar" territoret natyrore të kompleksit ligatinor të Butrintit deri tek Kepi i Stillos, me sip. 8591.2ha. Për këtë park është hartuar dhe plani i menaxhimit (Shtator 2010), i miratuar me urdhër të Ministrit të Mjedisit nr.404, datë 09.06.2011, por që nuk ka gjetur zbatim.

Njëherazi, territori natyror i kompleksit ligatinor të Butrintit (Liqeni i Butrintit, Parku Kombëtar i Butrintit, Kepi i Stillos, ishujt e Ksamilit) ka statusin e Zonë Natyrore veçanërisht e mbrojtur, për t'u përfshirë në listën e Konventës "Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë", me sipërfaqe të përgjithshme 13,500.0ha.

VKM n.881, **datë 03.11.2010**, caktoi vendet për vendosjen e antenave të komunikimit dhe të atyre radiotelevizive në territorin e Parkut Kombëtar "Mali i Dajtit"...

duke shpallur edhe një numër të konsiderueshëm (për frymë popullsie e sipërfaqe) zonash të mbrojtura, të mbështëtura këto dhe me aktet ligjore të nevojshme.

KDB parashikon një rol më të madh të zonave të mbrojtura në planet kombëtare e ndërkombëtare për biodiversitetin. Theksohet domosdoshmëria e krijimit dhe administrimit të rrjetit të zonave të mbrojtura. Po kështu përcaktohen edhe përparësitë dhe politikat globale për ruajtjen in-situ të biodiversitetit, duke i detyruar nënshkruesit të:

-ngrenë rrjetin e zonave të mbrojtura apo të zonave ku duhet të merren masa të veçanta për ruajtjen e biodiversitetit;

-hartojnë udhëzues/rregulla për *Vijon në faqe 14*

Vijon nga faqe 13 përzgjedhjen, ngritjen dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura apo të zonave ku duhet të merren masa të veçanta për ruajtjen e biodiversitetit;

-rregullojnë apo menaxhojnë burimet biologjike që janë të rëndësishme për ruajtjen e biodiversitetit si brenda dhe jashtë zonave të mbrojtura, me synim sigurimin e ruajtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të tyre;

-nxisin zhvillimin e qëndrueshëm e në përputhje me mjedisin në zonat pranë zonave të mbrojtura me synim mbrojtjen e mëtejshme të këtyre zonave;

-sigurojnë mbështetje financiare, etj, për ruajtjen in-situ.

Rrjeti i Zonave të Mbrojtur përbën një bazë të fuqishme, nëpërmjet nxitjes së identifikimit, për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore e natyrore në të gjithë botën. Në këtë kuadër të gjithë vëndet paraqesin propozimet e tyre për zonat që duhen përfshirë në Listën Zonave të Trashëgimisë Botërore, dhe kanë të drejtën të përfitojnë fonde nga Fondi i Trashëgimisë Botërore. Ky proces në vendin tonë ka nisur me Butrintin, i cili, më Shkurt 2000, u shpall Park Kombëtar dhe më pas po vijon me ekosistemin natyror të Ohër-Prespave.

Në zbatim të detyrimeve të konventës së KDB, me VKM nr. 31, datë 21.1.2016 u miratua "Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit" dhe plani i veprimit deri në vitin 2020. Ky dokument garanton kornizën kryesore politike për mbrojtjen e biodiversitetit. Për të arritur objektivin e përgjithshëm të këtij dokumenti strategjik të politikave, janë identifikuar prioritetet, qëllimet dhe objektivat specifike kombëtare të biodiversitetit.

Në pajtim me objektivat globale Aichi të biodiversitetit deri në vitin 2020 dhe në kuadrin më të gjerë të Dekadës së Kombeve të Bashkuara mbi Biodiversitetin 2011-2020, janë identifikuar këta objektiva kombëtarë në vijim:

1. Deri në vitin 2020, të sigurohet përafrimi dhe zbatimi i *acquis* të BE-së në fushën e mbrojtjes natyrore.

2. Deri në fund të vitit 2015, të ketë një dokument strategjik për biodiversitetin të rishikuar dhe të miratuar, në përputhje me objektivin e Aichi 17.

3. Deri në vitin 2020, të krijohet një objektivi i ruajtjes prej 17% të zonave ujore tokësore dhe në brendësi dhe 5% e zonave detare.

Krijimi i Rrjetit Kombëtar ekologjik i Shqipërisë, si një pjesë integrale e Rrjetit Ekologjik PanEvropian (PEEN), në përputhje me objektivin e Aichi 11.

4. Të rehabilitohen të paktën 15% e zonave të degraduara përmes aktiviteteve konservuese dhe restauruese, në përputhje me objektivat e biodiversitetit Aichi - ky veprim do të arrihet përmes zbatimit të planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura dhe përmes zbatimit të planeve të veprimit për llojet në veçanti dhe habitatet.

4. Bujqësi dhe pylltari më të qëndrueshme në përputhje me objektivat e biodiversitetit.

5. Zbatimi i protokollit Nagoya për aksesin dhe ndarjen e përfitimit të resurseve gjenetike dhe përfitimet që lindin nga përdorimi i tyre, në përputhje me objektivin e Aichi 16.

6. Ndërgjegjësimi mbi biodiversitetin, në përputhje me objektivin Aichi 1.

Objektiva të tjerë sektorialë strategjike për mbrojtjen e natyrës janë:

- Adresimi i shkaqeve të humbjes së biodiversitetit.

- Ulja e presioneve të drejtpërdrejta mbi biodiversitetin dhe promovimin e përdorimit të qëndrueshëm.

- Rritja e zbatimit përmes planifikimit me pjesëmarrje, menaxhimin e njohurive dhe ndërtimin e kapaciteteve.

- Rritja e përfitimeve për të gjithë, nga biodiversitet dhe shërbimet e ekosistemit.

- Përmirësimi i statusit të biodiversitetit duke ruajtur ekosistemet, llojet dhe diversitetin gjenetik.

- Një objektivi kombëtar, i cili është arritur tashmë, është Protokoli Nagoya, mbi Ratifikimin ABS - Aichi objektivi 16.

Konventa "Për ruajtjen e llojeve shtegëtare të botës së egër"(Bonit).

U nënshkrua më 23 Qershor 1979, në Bon. Shqipëria ka aderuar me Ligjin nr. 8692, datë **16.11.2000** "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Bonit "Për mbrojtjen e llojeve shtegëtare të kafshëve të egra" dhe mirëkuptimet e kësaj Konvente" (*Fletore Zyrtare nr. 43, datë 13.2.2000, faqe 1936*). Deri më sot janë nënshkruar dy protokolle të kësaj konvente "Për gjitarët e Mesdheut" dhe "Për *Numenius tenuirostris*". Kjo konventë është një marrëveshje

ndërqeveritare, e cila synon të ruajë të gjitha llojet migratore detare, tokësore dhe ujore, në tërë zonat ku bëhet migrimi. Shkak për arritjen e kësaj konvente u bë një rekomandim i Konferencës së Kombeve të Bashkuara, më 1972, për problemet e mjedisit njerëzor. Konventa ka një kuadër të përcaktuar veprimi për ruajtjen e llojeve migruese, të detyruar për t'u zbatuar nga të gjithë vendet të cilët e kanë pranuar, përfshi dhe vendin tonë.

NJOFTIME

Java e parë e Nëntorit - Java e Ujit në Shqipëri

4 Nëntor - Dita Botërore e Urbanizimit

18 Nëntor - Dita Botërore e Sistemeve të Informacionit Gjeografik / GIS

25 Nëntor - Dita Ndërkombëtare e Eleminimit të Dhunës ndaj Grave

Java e fundit e Nëntorit - Java Europiane për Reduktimin e Mbetjeve

1 - Për të lexuar "Ditari i Natyrës" në vite...

<http://www.inca-al.org/index.php/sq/publikimet/ditari-i-natyres>

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në Ditarin e tij elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes Ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia ruan të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.

Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

Grupimi "Të Shpëtojme Arinjtë Shqiptarë"



Organizatat Partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA
Redaksia: Nihat Dragoti; Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Marinela Mitro